



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.486/5 prot

Datë 23.02.2026

V E N D I M
Nr. 293/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.02.2026, shqyrtoi kërkesën me:

- Objekt:** Vendim për mbylljen e çështjes lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Filara Education” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me objekt: “Blerje libra artistikë për nevojat e MEPJ-së ” që janë me domen publik”, me fond limit: 6,071,388.33 (gjashtë milion e shtatëdhjetë e një mijë e treqind e tetëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, me Nr. REF-75442-02-06-2026, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 19.02.2026 nga Autoriteti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Filara Education” shpk, me NUIS M12117037V, Adresa: Rruga e Kavajës, Kompleksi Square 21, Shkalla 1, Apartamenti Nr. 29, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 24 e vijues, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 09.02.2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me objekt: “Blerje libra artistikë për nevojat e MEPJ-së ” që janë me domen publik”, me fond limit: 6,071,388.33 (gjashtë milion e shtatëdhjetë e një mijë e treqind e tetëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, me Nr. REF-75442-02-06-2026, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 19.02.2026 nga Autoriteti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

II.2. Në datën 16.02.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6334 dhe me nr. 4864 prot., datë 16.02.2026 e operatorit ekonomik “Filara Education” SHPK me anë të së cilës ka kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi si më poshtë:

Në datën 09.02.2026, publikohet në Sistemi Elektronik app.gov.al procedura e prokurimit publik me Objekt “Blerje libra artistikë për nevojat e MPEJ” që janë me domen publik nga Autoriteti Kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, me Fond Limit 6.071.388,33 dhe Nr.REF-75442-02-06-2026

Pasi u njohem me elementet kryesore të procedurës si preventivi I shërbimit dhe afati për realizimin e saj, ne Shoqëria “Filara Education” Sh.p.k e vlersuam me interes maksimal dhe menjëhër filluam përgatitjet për përgatitjen e dokumentave për pjesmarrje në procedurën si më sipërcituar. Në gjykimin tonë zotërojmë kapacitetet ligjore financiare dhe teknike për realizimin e procedurës objekt prokurimi.

Por, gjatë shqyrtimit të “ Kriteve të Vecanta për Kualifikim” Konkretisht të pikës 2.3.2, u informuam me një kërkesë të pazakontë e cila në arsyetimin tonë është në kundërshtim me proporcionalitetin dhe barazinë në pjesëmarrje për procedurat e prokurimit publik.

Paraprakisht, dëshirojmë t'ju parashetrojmë kërkesën e Autoritetit Kontraktor, në pikën 2.3.2 në Seksionin e “Kriteve të Vecanta për Kualifikim” të DST-së (Dokumentave Standatarte të Tenderit), si më poshtë vijon:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë dhe të dorëzojë për titujt e librave në publik domain në gjuhë të huaj kontratën e noterizuar me përkthyesin ku përcaktohet afati kohor i botimeve për të gjithë titujt e librave në gjuhë të huaj objekt prokurimi. Në rastet kur pjesëmarrës nuk është vetë botuesi për titujt e librave në publik domain duhet të paraqesë autorizimin nga botuesi i cili i jep të drejtën të tregëtojë titujt e tij.

Së pari, nga shqyrtimi i listës së titujve rezulton se të gjithë librat e përfshirë në këtë procedurë objekt prokurimi janë vepra që i përkasin domenit publik, në kuptim të legjislacionit në fuqi për të drejtën e autorit. Sipas :igjit Nr. 35/2016 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të”, i ndryshuar, të drejtat pasurore mbi një vepër janë të kufizuara në kohë dhe, pas përfundimit të afatit ligjor, vepra hyn në domenin publik. Për veprat në domen publik nuk ekziston më e drejtë ekskluzive shfrytëzimi ekonomik dhe çdo subjekt ka të drejtë t'i botojë, ribotojë dhe tregtojë ato pa pasur nevojë për autorizim nga palë të treta.

Në këto kushte, kërkesa për autorizim nga botues të tjerë për tregtimin e titujve në domen publik rezulton e pambështetur në legjislacionin për të drejtën e autorit, pasi botuesit e ndryshëm nuk gëzojnë të drejtë ekskluzive mbi veprën që të mund të japin apo refuzojnë autorizime për tregtimin e saj. Veprat në publik domen janë jashtë mbrojtjes së të drejtës së autorit ,rrjedhimisht konsiderohen si vepra që mund të kenë përdorim të lirë për publikun.

Për më tepër këtë pretendim e bazojmë në Nenin 41, Pika Nr.10 të Ligjit Nr. 35/2016 “Për të drejtat e Autorit dhe të Drejtja të Tjera të lidhura me to” I cili shprehimisht citon që:

“Me mbarimin e afatit të mbrojtjes së të drejtave pasurore,vepra konsiderohet vepër në domen publik dhe mund të ketë përdorim të lirë për publikun,duke iu nënshtruar respektimit të të drejtave morale të autorëve,sipas parashikimeve të këtij ligji”.

Pra ligji shprehet qartë për rrethanat në të cilat do të ishim të detyruar të respektonim të drejtat e autorit por gjithashtu bën edhe një përcaktim të rëndësishëm për përdorimin e lirë të këtyre veprave pa kufizim.Në këtë rast nuk ka asnjë kufizim ligjor në përdorimin e veprës

përvec respektimit të drejtave morale të autorit ,duke mos përfshirë në kuadrin e mbrojtjes të drejtat pasurore të botuesit.

Gjithashtu nenin e sipërcituar e gjejmë të lidhur edhe me Nenin 42, Pika 1, Shkronjat “a”, “b”, Pika 2 dhe Pika 3 e tij, I cili përcakton qartë edhe rastet kur cdo person që publikon një vepër të domenit publik gëzon të drejta pasurore edhe pse të drejtat pasurore të autorit të veprës janë shuar ligjërishtë, konkretisht:

“Përfitojnë një mbrojtje të njëjtë lidhur me të drejtat pasurore ,sikurse autori I veprës,cdo person ,I cili pas përfundimit të mbrojtjes së të drejtave pasurore të autorit:

a) publikon për herë të parë në mënyrë të ligjshme ose e vendos po në mënyrë të ligjshme në dispozicion të publikut një vepër të pabotuar më parë.

b) publikon një botim kritik dhe shkencor të një vepre që është bërë pjesë e domenit publik.

Në këtë rast ligji shpreh qartë rastet kur e drejta pasurore e botimit të një libri ,pjesë të domenit publik, gëzon të drejtën e mbrojtjes pasurore, Referuar shkronjës “a” bëhet fjalë për një vepër e cila nuk është botuar kurrë nga autori I veprës, dhe publikohet ekskluzivisht për herë të parë, dhe ku e drejta pasurore e botuesit mbrohet për 25 vite nga koha kur vepra u botua (Neni 42 Pika 2, “Afati I mbrojtjes së të drejtave pasurore ,të përmendura në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni, është 25 vjet nga koha kur vepra u botua për herë të parë apo u vendos në mënyrë të ligjshme në dispozicion të publikut).

Titujt e përfshirë në artikujt e tenderit janë vepra të cilat janë botuar më parë nga autorët dhe rrjedhimisht ku është rasti që mbrojtja e të drejtave pasurore të botuesit nuk qëndron.

Mbrojtja e të drejtave pasurore të publikuesit të një vepre të domenit publik vlen vetëm për botime të karakterit kritik dhe shkencor ,shprehimisht pika 3 e nenit 42,- “Afati I mbrojtjes së të drejtave pasurore,të përmendura në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni ,është 30 vjet nga koha e publikimit të parë të ligjshëm”.

Bazuar në listën e artikujve që procedura objekt prokurimi na rezulton se nuk gjenden botime të karakterit kritik apo shkencor,dhe si pasojë këto botime nuk mund të cilëson si vepra të cilat I nënshtrohen mbrojtjes së të drejtave pasurore të botuesve në kuptimin e domenit publik sipas ligjit te drejtës së autorit.

Me pak fjalë, në gjithëshka që thamë më sipër e shohim të pambështetur dhe të pajustificuar në ligj kërkesën nga autoriteti për detyrimin e operatorëve ekonomik të paraqesin autorizim nga botuesit e këtyre veprave I cili jep të drejtën të tregëtojnë titujt e tij.

Së dyti, ky kriter bie ndesh me parimet themelore të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” konkretisht të Neni-t 2 i këtij ligji parashikon parimet e barazisë në trajtim, mosdiskriminimit, proporcionalitetit dhe konkurrencës së lirë. Vendosja e një kriteri që kushtëzon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë me sigurimin e autorizimeve nga subjekte të tjera që operojnë në të njëjtin treg krijon një varësi nga vullneti i palëve të treta, duke cenuar konkurrencën reale dhe duke vendosur barriera të panevojshme hyrëse në treg.

Në përputhje me Nenin 36 të ligjit nr. 162/2020, kriteret e kualifikimit duhet të jenë të lidhura ngushtë dhe proporcionale me objektin e kontratës, si dhe të mos krijojnë kufizime të pajustificuara të konkurrencës. Në rastin konkret, kërkesa për autorizime masive për një numër të konsiderueshëm titujsh dhe botuesish, për vepra juridikisht të lira për tregtim, përbën një barrë të tepruar administrative që nuk lidhet me kapacitetin teknik apo profesional të operatorit për të realizuar kontratën.

Gjithashtu, bazuar në përvojën e mëparshme në procedura të ngjashme, rezulton se vendosja e kriterëve të tilla për autorizim ka sjellë vështirësi serioze në zhvillimin normal të procedurave të prokurimit. Sipas informacionit të disponueshëm publikisht dhe praktikës së njohur në treg, në disa procedura të mëparshme të zhvilluara nga DRAP Korçë dhe DRAP Fier, kërkesa për autorizime nga botues të tjerë ka krijuar situata bllokimi për operatorët ekonomikë, duke çuar në vonesa të konsiderueshme procedurale dhe duke rrezikuar dështimin ose anulimin e procedurave për mungesë konkurrence efektive.

Këto raste tregojnë se vendosja e një kriteri të tillë, veçanërisht kur bëhet fjalë për tituj në domen publik, nuk kontribuon në garantimin e cilësisë apo ligjshmërisë së furnizimit, por përkundrazi rrezikon të kufizojë pjesëmarrjen dhe të cenojë efektivitetin e procedurës së prokurimit.

Duke qenë se përmbushja e këtij kriteri nuk varet nga aftësitë apo kapacitetet e operatorit ekonomik, por nga vullneti i subjekteve të tjera konkurrençe që operojnë në të njëjtin treg, vlerësojmë se ai nuk përmbush standardin e proporcionalitetit dhe lidhjes me objektin e kontratës, sipas kërkesave të ligjit nr. 162/2020.

Për sa më sipër, kërkojmë nga Autoriteti kontraktues/ Komisioni i Prokurimit Publik shqyrtimin e këtij ankimi dhe rishikimin e kriterit të autorizimit, me qëllim përshtatjen e tij në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik dhe atë për të drejtën e autorit, si dhe garantimin e konkurrencës së lirë dhe efektive dhe të gjendur në këto kushte kërkojmë, ndryshimin dhe riformulimin e dokumenteve të procedurës në përputhje me legjislacionin në fuqi konkretisht të pikës 2.3.2. të saj, në përshtatje të plotë me dispozitat ligjore të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” me qëllim një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues të Operatorevë Ekonomikë.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me shkresën nr.325/5 prot., datë 19.02.2026, protokolluar me tonën me nr.486/1 prot., datë 20.02.2026 dhe nr. 486/2, datë 23.02.2026, me objekt “Vendim”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi KSHA-së nga ku rezulton, se autoriteti kontraktor pasi ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues në përfundim ka vendosur praninë të plotë të saj duke vendosur heqjen e kriterit 2.3.2 në Seksionin e “Kritereve të Vecanta për Kualifikim” të DST-së (Dokumentave Standatarte të Tenderit).

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit “Filara Education” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës për modifikimin e Kriterit të veçantë të kualifikimit, pika 2.3.2, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Referuar shkresës së autoritetit kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a. nr. nr.325/5 prot., datë 19.02.2026, protokolluar me tonën me nr.486/1 prot., datë 20.02.2026, rezulton se ankesa është pranuar plotësisht.

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 114 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se:
1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;*
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;*
- c) refuzimin e ankesës.*

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.5. Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga verifikimi i shkresës nr. nr.325/5 prot., datë 19.02.2026, protokolluar me tonën me nr.486/1 prot., datë 20.02.2026, të dorëzuar pranë KPP-së, nga autoriteti kontraktor, konstatohet se ky i fundit, ka vendosur pranim plotësisht të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, kështu që rrjedhimisht Komisioni do të mbyllë çështjen në lidhje me këto pretendime, për sa kohë ato janë pranuar nga vetë autoriteti kontraktor.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 pika 1, 115 pika 1 dhe 3 si dhe neni 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të

Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë komisionit të prokurimit publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Filara Education” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me objekt: “Blerje libra artistikë për nevojat e MEPJ-së ” që janë me domen publik”, me fond limit: 6,071,388.33 (gjashtë milion e shtatëdhjetë e një mijë e treqind e tetëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, me Nr. REF-75442-02-06-2026, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 19.02.2026 nga Autoriteti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
2. Autoriteti kontraktor, të kryejë modifikimet e DST sipas konstatimeve të KSHA për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Filara Education” SHPK.
5. Kopje e këtij vendimi t'i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergji Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

